



Prishtinë: 29.03.2018
Kodi i ZRRE-së: V_956_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1718_10_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **24.10.2017**.

në seancën e mbajtur më datë 29.03.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin M.A. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90062191 si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1718_10_17** i datës 30.10.2017.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 18.07.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: për periudhën 04/2016 deri më 08/2016 është bërë korrigjimi në vlerë prej -141.50€ dhe atë për shkak të grupit tarifor nga 7/02 në 4/02. Në ankesë poashtu është theksuar se përmes procesverbalit nr.0757333 të datës 15.07.2015 dhe procesverbalit nr.076077 të datës 15.07.2015 ka konstatuar se konsumatori shfrytëzon energji si konsumator komercial dhe se edhe pas ankesës së konsumatorit punëtorët e KEDS përmes procesverbalit nr.0935105 të datës 29.07.2015 objekti shfrytëzohet si komercial dhe ka udhëzuar konsumatorin për ndarjen e instalimit për zyre dhe amvisëri. .

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e ZRRE/DMK_V_1718_10_17, në lidhje me shifrën DPR - 90062191 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE pikën e kundërshtimit të KESCO lidhur me faturimin e energjisë elektrike për faturimin e konsumatorit me tarifa të grupit tarifor 4 (7/02)) dhe me tarifa të grupit tarifor shtëpiak 5 (4/02) dhe thekson se sipas rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit shifra DPR-



90061291 është hapur me datë 21.06.2010, dhe atë si konsumatorë shtëpiak me grup tarifor 5 (4/02) dhe me numër njehsori 60098794. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se ky konsumator nga periudha 21.06.2010 e deri më 06/2015 është faturuar si konsumatori shtëpiak i grupit tarifor 5 (4/02) dhe se nga periudha 07/2015 e deri më 08/2016 është faturuar si konsumatori komercial i grupit tarifor 4 (7/02), si dhe prej periudhës 09/2016 e tutje prapë konsumatori faturohet si konsumatori shtëpiak i grupit tarifor 5 (4/02).

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se organi i shkallës së parë gabimisht ka konstatuar se KESCO nuk a arritur të argumentojë se për çfarë arsye është bërë ndërrimi i grupit tarifor, Bordi i ZRRE-së ka analizuar përgjigjen e KESCO-s dhënë konsumatorit dhe se aty është vërejtur se KESCO ka dhënë sqarime për korigjimin e faturave 04/2016 e deri më 08/2016 në vlerë prej -141.50€ dhe atë bazuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr.0604925 të datës 07.04.2016, por që nuk ka dhënë asnjë sqarim se pse nga data 07/2015 është bërë ndërrimi i grupit tarifor, mbi bazën e cilit dokument është bërë ndërrimi i grupit taifor. Andaj edhe Bordi konstaton se përgjigja e KESCO-s dhënë konsumatorit është shumë e mangët dhe nuk jep asnjë sqarim për ndërrimin e grupit tarifor të konsumatorit nga data 07/2015 e deri më 08/2016.

Gjatë analizave të bëra listave të leximit të periudhave 05/2015 e deri më 10/2016 kemi vërejtur se lexuesi i KEDS-it ka bërë lexim të rregullt të njehsorit elektrik. Nga listat vërehet se muajt 05/2015 dhe 06/2015 lexuesi ka evidentuar se nuk ka çasje te pika matëse por ka evidentuar shpenzim, në muajin 07/2015 ka evidentuar se ka çasje dhe ka marrë gjendjen e shpenzimit, në muajin 08/2015 lexuesi ka evidentuar se nuk ka çasje te pika matëse por ka evidentuar shpenzim, ndërsa nga muajit 09/2015 – 10/2016 lexuesi ka evidentuar se ka çasje dhe ka marrë gjendjen e shpenzimit. Duhet theksuar se në këto lista të leximit nuk është evidentuar se pse është bërë ndërrimi i grupit tarifor.

Bordi i ZRRE-së konstaton se faturimi i konsumatorit nga periudha 07/2015 e deri më 08/2016 si konsumator komercial i grupit tarifor 4 (7/02) nga ana e KESCO-s është bërë gabim pasi është dashur të faturohet si konsumator shtëpiak i grupit tarifor 5 (4/02) ashtu siç është faturuar deri në atë periudhë dhe se ndërrimi i grupit tarifor nga ana e KESCO-s-it është në kundërshtim me nenin 23 paragrafin 1 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji ku thuhet se: *"Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)".* Andaj lidhur me këtë mund të konstatojmë se KESCO nuk ka arritur të argumentojë se me çfarë baze e ka ndërruar grupin tarifor konsumatorit në periudhën 07/2015 e deri më 08/2016.

Bordi i ZRRE-së duke bazuar në shkresat e lëndës, procesverbalin e ndërrimit të njehsorit nr.0604925 të datës 07.04.2016, rrjedhën e energjisë elektrike aktive, transaksionet e konsumatorit dhe mos argumentimin e KESCO për ndërrim të grupit tarifor, pasi që në asnjërin prej dokumenteve të mëhershme nuk janë evidentuar procesverbalet e datës 15.07.2015, konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korigjimi i faturave nga periudha 07/2015 deri në periudhën 08/2016, duke ri faturuar konsumatorin për këtë periudhë kohore me tarifa të grupit tarifor 5 ose 6, varësisht nga muaji (tarifa të konsumatorëve shtëpiak)

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit Mehmet Ahmetaj dhe,
- Arkivit të ZRRE-së.